



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

*Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër,
e-mail: keshilibashkiak@bashkiashkoder.gov.al*

ëeb: ëëë.bashkiashkoder.gov.al

DRAFT/RREGULLORE

**Për titujt vendorë të nderit në Bashkinë Shkodër,
kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre**

2023

Neni 1 **Baza ligjore**

Bazë ligjore në hartimin e kësaj rregullore janë:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 113, pika I shkronja “dh”.
2. Ligji nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.
3. Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54 shkronja “k” dhe “m”.
4. Ligji nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”.
5. VKM nr. 861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2 **Objekti**

1. Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i llojeve të titujve të nderit që jepen nga Bashkia Shkodër, kriterëve dhe procedurës për dhënien e tyre.

Neni 3 **Parime të përgjithshme**

1. Titujt e nderit u jepen individëve/ personave fizik ose juridik vendas ose të huaj, të cilët kanë një kontribut të shquar në dobi të bashkësisë së Bashkisë Shkodër, në fushat e ndryshme të jetës si: historike, kulturore, sportive, muzikore, artistike, arsimore, humanitare, komunitare, promovuese, patriotike, mjedisore, shkencore.
2. Dhënia e titujve të nderit, udhëhiqet nga parimet e vlerësimit të kontributit, meritokracisë, transparencës dhe mirënjohjes publike.
3. Përfitimi i një titulli nderi nuk është një e drejtë dhe nuk mund të kërkohet si e tillë, në rrugë individuale apo institucionale.

Neni 4 **Përjashtimet nga titujt e nderit**

Personi që ka marrë një dekoratë nga Presidenti i Republikës nuk mund të përfitojë më vonë në kohë medalje apo titull vendor nderi.

Neni 5

Llojet e titujve vendorë të nderit dhe kriteret për dhënien e tyre

Bashkia Shkodër jep këto tituj vendorë nderi:

1. “Qytetar Nderi”

Titulli “Qytetar Nderi” është titulli më i lartë që jepet në Bashkinë Shkodër.

Ky titull i jepet personaliteteve shqiptarë ose të huaj, për veprimtari të shquar në dobi të Bashkisë Shkodër ose për veprimtari për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të saj.

2. “Mirënjohje e Bashkisë Shkodër”

Ky titull u jepet individëve/ personave fizik apo juridik, vendas ose të huaj që kanë kontribut të pasur në dobi të bashkësisë së Bashkisë Shkodër, në fushat e ndryshme të jetës shoqërore si: kulturore, historike, sportive, muzikore, artistike, arsimore, humanitare, etj.

3. Titull i veçantë vendor nderit

- Ky titull jepet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuar në nenin 10 të ligjit nr.94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë”

Neni 6

Autoriteti përgjegjës

1. Autoriteti përgjegjës për dhënien e titujve vendorë të nderit në Bashkinë Shkodër është Këshilli Bashkiak Shkodër.
2. Të drejtën për të propozuar dhënien e titullit vendor të nderit e ka:
 - a) kryetari i bashkisë;
 - b) çdo këshilltar bashkiak.
 - c) Prefekti I qarkut

Neni 7

Komisioni këshillimor

1. Këshilli Bashkiak Shkodër krijon pranë tij një komision këshillimor, të përbërë prej 5 (pesë) anëtarësh, prej të cilëve 3 (tre) anëtarë duhet të jenë anëtarë të Këshillit të Bashkisë Shkodër, të cilët përfaqësojnë grupet politike me përfaqësimin më të madh në KB dhe 2 (dy) anëtarë personalitete të jashtme, që përzgjidhen mes njerëzve të shquar dhe që kanë dhënë kontribut në fushën përkatëse. Emërimi i anëtarëve të komisionit bëhet nga kryetari i këshillit bashkiak.
2. Komisioni ngrihet, me urdhër të kryetarit të këshillit bashkiak çdo fillim viti kalendarik.
3. Komisioni funksionon si organ kolegjal këshillimor, pranë këshillit bashkiak.
4. Në rast krijimi të vakancës të ndonjë anëtari të komisionit, ajo plotësohet brenda 10 ditëve nga krijimi i vakancës, duke respektuar përbërjen e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 8

Organizimi dhe funksionimi i komisionit këshillimor

1. Komisioni, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh, me shumicë votash, kryetarin dhe sekretarin e tij.
2. Kryetari thërret dhe drejton mbledhjen, drejton diskutimet, siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta.
3. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve bëhen brenda 10 (dhjetë) ditëve, pas paraqitjes së kërkesës dhe, të paktën, 48 orë para datës së thirrjes së mbledhjes.
4. Lajmërimi për thirrjen e një mbledhjeje duhet të tregojë, në mënyrë të qartë dhe të detajuar, çështjet për të cilat do të diskutohet, orën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes. Mbledhja është e vlefshme edhe kur nuk respektohen procedurat e parashikuara më sipër, vetëm në rast se në atë mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët, të cilët, paraprakisht, miratojnë zhvillimin e mbledhjes.
5. Mbledhjet e komisionit zhvillohen kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij.

Neni 9

Paraqitja e propozimit dhe dokumentacioni shoqërues

1. Propozimi dhe dokumentacioni për dhënien e titullit vendor të nderit paraqitet në zyrën e protokollit të bashkisë ose zyra me një ndalesë dhe i drejtohet këshillit bashkiak Shkodër.
2. Dokumentacioni duhet të përmbajë, si rregull:
 - a) propozimin për dhënin e titullit të nderit dhe arsyet që çojnë në këtë propozim;
 - b) autoritetin propozues;
 - c) cv / jetëshkrim i/e personit të propozuar dhe kopje dokument identifikimi të tij;
 - ç) miratimin/ dakortësinë e personit të propozuar;

- d) vërtetim/ vetëdeklarim se personi i propozuar nuk është dënuar ndonjëherë, ose nuk është nën hetim;
- dh) letër rekomandimi nga një institucion i të njëjtës linjë me të cilin është i lidhur aktiviteti profesional i personit të propozuar (nëse ka);
- e) materiale dokumentuese që dëshmojnë për arritjet e personalitetit gjatë jetës së tij, si çertifikata, diploma, fletë falenderimi ose mirënjohje etj., të cilat ndihmojnë këshilltarët të kenë një informacion më të plotë të propozimit për dhënien e titullit;
- ë) deklaratë se personit të propozuar nuk i është akorduar më parë një titull tjetër i nivelit më të lartë se ai vendor;
- f) çdo propozim për dhënie titulli duhet të shoqërohet me motivacionin përkatës në mënyrë të përmbledhur, motivacion i cili mund të rishqyrtohet nga komisioni këshillimor.

Neni 10

KRIJIMI I KOMISIONIT KËSHILLIMOR

1. Çdo autoritet, përgjegjës për dhënien e medaljeve ose titujve vendorë të nderit, sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e dekoratave, titujve të nderit, medaljeve dhe titujve vendorët të nderit, krijon pranë tij një komision këshillimor, në vijim "komisioni", të përbërë prej 5 (pesë) anëtarësh, prej të cilëve 3 (tre) anëtarë duhet të jenë punonjës në varësi të autoritetit përgjegjës dhe 2 (dy) anëtarë personalitete të jashtme, që përzgjidhen mes njerëzve të shquar dhe që kanë dhënë kontribut në fushën përkatëse.

2. Komisioni ngrihet, me urdhër të titullarit të autoritetit përgjegjës, çdo fillim viti kalendarik. Për vitin 2024, komisioni të ngrihet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi. 3. Komisioni funksionon si organ kolegjal, vendimmarrës, pranë autoritetit përgjegjës për dhënien e medaljeve apo titujve vendorë të nderit.

Neni 11

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT KËSHILLIMOR

1. Komisioni, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh, me shumicë votash, kryetarin dhe sekretarin e tij.

2. Kryetari drejton mbledhjen, drejton diskutimet, siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta.

3. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve bëhen brenda 10 (dhjetë) ditëve, pas paraqitjes së kërkesës dhe, të paktën, 48 orë para datës së thirrjes së mbledhjes.

4. Lajmërimi për thirrjen e një mbledhjeje duhet të tregojë, në mënyrë të qartë dhe të detajuar, çështjet për të cilat do të diskutohet, orën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes.

5. Mbledhja është e vlefshme edhe kur nuk respektohen procedurat e parashikuara më sipër, vetëm në rast se në atë mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët, të cilët, paraprakisht, miratojnë zhvillimin e mbledhjes.

6. Mbledhjet e komisionit zhvillohen kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij.

Neni 12

VENDIMMARRJA DHE MËNYRA E VOTIMIT

1. Të gjitha propozimet për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit i dërgohen autoritetit përgjegjës për dhënien e tyre, i cili i përcjell për vlerësim në komisionin këshillimor.

2. Komisioni shpreh mendimin e vet edhe nëse nisma për dhënien e medaljeve ose titujve vendorë të nderit është ndërmarrë nga autoriteti përgjegjës për dhënien e tyre.

3. Komisioni nis punën me verifikimin e të gjitha elementeve, të kërkuara nga neni 18, i ligjit nr. 112/2013, "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", të aktit të propozimit.

4. Nëse propozimi nuk është i plotë, komisioni këshillimor kërkon, me shkrim, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike, nga data e marrjes së propozimit, plotësimin e tij nga autoriteti propozues. Plotësimi i propozimit bëhet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga data e marrjes së njoftimit.

5. Nëse propozimi është i plotë, komisioni këshillimor paraqet mendimin e vet pranë autoritetit përgjegjës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së propozimit

Komisioni shqyrton propozimet dhe merr vendimin me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Votimi është i hapur.

8. Anëtarët e komisionit, që janë të pranishëm në mbledhje, nuk mund të abstenojnë.

9. Kryetari i organit kolegjal voton i fundit.

10. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, në të cilin pasqyrohen data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që marrin pjesë, çështjet që diskutohen, vendimet e marra, si dhe mënyra dhe rezultati i votimeve.

11. Procesverbali mbahet nga sekretari dhe duhet t'u paraqitet, për miratim dhe nënshkrim, të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse.

12. Në rastet kur vetë organi e shikon të arsyeshme dhe mbledhja është e ndarë në seanca, procesverballi miratohet menjëherë pas përfundimit të seancës përkatëse.

13. Anëtarët mund të kërkojnë që të shënohet në procesverbal fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi.

14. Procesi i shqyrtimit të propozimit mund të shtyhet apo të pezullohet përkohësisht, për rrethana të paparashikuara, që dëmtojnë reputacionin dhe vlerën e aktit të medaljes ose titullit vendor të nderit në opinionin publik, deri në sqarimin e këtyre rrethanave. Arsyet e shtyrjes apo të pezullimit, si dhe afati, pasqyrohen në procesverbal.

15. Kur propozimi për dhënien e medaljes apo titullit vendor të nderit nuk miratohet, komisioni njofton autoritetin propozues për mosmiratimin. Në çdo rast, vendimi i arsyetuar dhe procesverballi i mbledhjes i përcillen autoritetit përgjegjës për miratimin e propozimit.

16. Në rast se propozimi miratohet nga autoriteti përgjegjës, urdhri ose vendimi i dërgohet komisionit për përgatitjen e medaljeve, rrathëve të argjendte dhe certifikatave përkatëse, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit.

17. Komisioni ndjek procedurën e përgatitjes së medaljeve, rrathëve të argjendte dhe certifikatave përkatëse. Pas përgatitjes së tyre, komisioni njofton autoritetin propozues për organizimin e ceremonisë për dhënien e dekoratës, titullit të nderit, medaljes ose titullit vendor të nderit si dhe për programin, kohën dhe vendin ku do të zhvillohet ceremonia

Neni 13

Miratimi i propozimit

1. Keshilli Bashkiak është autoriteti përgjegjës për miratimin ose jo të propozimit për dhënien e titullit vendor të nderit.
2. Votimi për propozimin e dhënies së titullit vendor të nderit bëhet i fshehtë.
3. Që votimi të jetë i vlefshëm, duhet të marrin pjesë në votim më shumë se gjysma e të gjithë këshilltarëve. Propozimi quhet i miratuar kur kanë votuar "Pro" shumica e këshilltarëve që kanë marrë pjesë në votim.

Neni 14

Konfidencialiteti i procedurës

1. Komisioni këshillimor, këshilltarët dhe nëpunësit, të cilët vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë e diskutimeve, mendimeve të shprehura dhe të dhënat personale për personat që propozohen për dhënie titulli nderi, të cilat mund të dëmtojnë reputacionin e tij.
2. Kur komisioni këshillimor voton kundra apo jep mendime dhe vlerësime kundër dhënies së titullit të nderit për personin e propozuar këto mbahen konfidenciale sipas pikës 1 të këtij neni. Kryetari dhe Sekretari i KB kujdesen që edhe këshilltarëve gjatë shpërndarjes së materialit të mbledhjes për këtë pikë të sigurojë konfidencialitetin në mënyrë që këto të dhëna të mos bëhen publike, përveç rasteve të parashikuara me ligj.
3. Gjatë mbledhjes së Këshillit Bashkiak nëse nga këshilltarë të veçantë kërkohet që të diskutohet për aspekte të veçanta të jetës të personit që propozohet për dhënie titulli nderi apo vihen në diskutim kontributet e tij, mbledhja zhvillohet me dyer të mbyllura gjatë zhvillimit të diskutimeve dhe debateve për këtë çështje.

Neni 15

Evidentimi i titujve të nderit

1. Titujt e nderit që jepen nga këshilli bashkiak publikohen dhe evidentohen në një regjistër të veçantë, i cili administrohet nga sekretaria e këshillit bashkiak.
2. Një përmbledhje e nxjerrë nga regjistri për personat e nderuar nga Bashkia Shkodër me tituj dhe motivacioni i tyre duhet të bëhet publik në faqen zyrtare ëeb të Bashkisë Shkodër.

Neni 16

Dispozita tranzitore

1. Komisioni i vlersimit të figurave të shquara dhe emërtesave në Këshillin Bashkiak brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga miratimi i kësaj rregulloreje harton dhe miraton formatin dhe elementet tip të çertifikatave të titujve të nderit për Bashkinë Shkodër dhe ia përcjell Sekretarit të KB-së.
2. Sekretari i Këshillit Bashkiak brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga miratimi i kësaj rregulloreje verifikon regjistrin e veçantë të titujve të nderit, e plotëson dhe e azhiron nga çdo mangësi, përfshirë edhe heqjen e emrave të personave që mund t'i jetë hequr titulli sipas legjislacionit në fuqi. Ky Informacion i nxjerrë nga regjistri për personat e nderuar nga Bashkia Shkodër me tituj dhe motivacioni i tyre duhet të bëhet publik në faqen zyrtare ëeb të Bashkisë Shkodër.

Anëtarët e Komisionit ad hoc për titujt e nderit dhe emertesave:

1. Uarda Gjekaj
2. Florian Bianku
3. Plarent Anamali
4. Muharrem Shkaju
5. Marina Duhani
6. Gloria Shllaku
7. Amina Lici